



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 613, Datë 19.04.2019

“Mospranimi i kërkesës së Bankës së Shqipërisë në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.04.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Shqyrtimin e kërkesës së Bankës së Shqipërisë, në lidhje me rekomandimet e dhëna me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës.

Baza Ligjore: Neni 24, germa d) dhe f), neni 46 i ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, neni 12, germa a) i ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të informacionit të Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me shkresën nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje”, të Bankës së Shqipërisë, për rekomandimet e dhëna nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 580 datë 17.01.2019 “Mbi përfitim të kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”,

VËREN SE :

Komisioni i Konkurrencës, duke vlerësuar se Banka e Shqipërisë në zbatim të nenit 12, germa a) të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është rregullatori i sistemit bankar, dhe është ekskluzivisht përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së bankave të nivelit të dytë, ku midis të tjerave ajo nxjerr akte ligjore dhe nënligjore për rregullimin e këtij tregu, me vendimin nr. 594, datë 07.02.2019 “Mbi zbatimin e rekomandimeve të dhëna Bankës së Shqipërisë me Vendimin nr. 580, datë 17.01.2019 të Komisionit të Konkurrencës”, vendosi t’i rekomandojë Bankës së Shqipërisë zbatimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës, përkatësisht për pikën 2, germa a) dhe b) të tij.

Banka e Shqipërisë, me shkresën nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje”, vlerëson se çështjet e ngritura nga Autoriteti i Konkurrencës janë objekt i punës në ushtrim të funksioneve mbikëqyrëse të Bankës së Shqipërisë në lidhje me personat e lidhur në marrëdhënie të veçantë me bankën, por pavarësisht këtij fakti, ajo nuk mund të mbikëqyrë dhe të marrë masa për shoqëri tregtare që nuk ushtrojnë veprimtari bankare dhe financiare.

Për këto arsye, Banka e Shqipërisë sugjeroi që brenda kompetencave që njeh ligji, të rishikohet dhe tërhiqet rekomandimi i lënë për Bankën e Shqipërisë, në lidhje me mënyrën e mbikëqyrjes së marrëdhënies së Bankës Tirana me personat e lidhur.

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, me shkresën nr. 484/15, datë 16.04.2019 ftoi Bankën e Shqipërisë për t’u dëgjuar për sa më sipër. Në përgjigje të ftesës, Banka e Shqipërisë, nëpërmjet shkresës nr. 2087/1, datë 17.04.2019, shprehet se u qëndron vlerësimeve të saj, të bëra me shkresën nr. 925, datë 29.01.2019 dhe shkresën nr.910/2, datë 01.04.2019.

Në zbatim të nenit 46, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, Komisioni i Konkurrencës ka të drejtë të revokojë ose të ndryshojë vendimet e veta, duke vendosur kushte dhe detyrime, ose të rifillojë procedurën, kur:

- a. njëri ose disa nga faktet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e vendimit, kanë ndryshuar;
- b. palët shkelin një ose disa detyrime, të parashikuara në vendim;
- c. vendimi është bazuar në të dhënat jo të sakta ose është marrë nëpërmjet mashtrimit.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës, nuk gjen as edhe një shkak ligjor, që ta lejojë atë që të revokojë ose të ndryshojë vendimin e tij.

Në këtë kontekst, është e pa argumentuar dhe nuk qëndron ligjërish, kërkesa e bërë nga Banka e Shqipërisë, që Komisioni i Konkurrencës të rishikojë dhe të tërheqë rekomandimet e tij.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe f dhe nenit 70 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës nr. 910/2 prot., datë 01.04.2019 “Kthim përgjigje” të Bankës së Shqipërisë.
2. Lënien në fuqi të rekomandimeve të dhëna sipas pikës 2, germa a) dhe b) të Vendimit nr.580, datë 17.01.2019 “Mbi përfundimin e kontrollit nëpërmjet shitblerjes së 98,83% të aksioneve të Tirana Bank SHA nga Piraeus Bank SA tek Balfin SHPK dhe Komercijalna Banka Ad Skopje”.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS